

L I G J
Nr.9520, datë 25.4.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE SHITESË NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE E FONDI I ZHVILLIMIT
SHQIPTAR, SI AGJENCI E ZBATIMIT TË PROJEKTIT DHE KREDITANSTALT FÜR
WIEDERAUFBAU (KfW) TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT TË PROJEKTIT “FONDI I
INVESTIMEVE SOCIALE-II””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Fondi i Zhvillimit Shqiptar, si agjenci e zbatimit të projektit dhe Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) të Marrëveshjes së Financimit të Projektit “Fondi i Investimeve Sociale-II””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4862, datë 10.5.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE

FINANCIARE PLOTËSUESE E DATËS PËR MARRËVESHJEN FINANCIARE, MARRËVESHJEN E
HUASË DHE MARRËVESHJEN E PROJEKTIT TË DATËS 5.10.2002 MIDIS KfW, FRANKFURT AM
MAIN (“KfW”) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE, TIRANË (“HUAMARRËSI”) DHE FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT (“AGJENCIA E
ZBATIMIT TË PROJEKTIT”)
PËR EURO 216,412.24
FONDI I ZHVILLIMIT SOCIAL II

Bazuar në një marrëveshje ende për t’u përfunduar midis Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar (“Marrëveshje Qeveritare”), Huamarrësi dhe KfW-ja hyjnë këtu në këtë Marrëveshje Financiare Plotësuese:

SEKSIONI 1
MODIFIKIME TË MARRËVESHJES SË HUASË

1.1. Dispozitat e mëposhtme të marrëveshjes financiare, marrëveshjes së huasë dhe marrëveshjes së projektit të datës 5.10.2002 për euro 2 045 167.52 (Huaja) dhe për euro 255 645.94 (kontributi financiar) do të modifikohen si vijon:

a) Neni 1.1, fjalë 1:

“KfW do t’i japë Huamarrësit një hua që nuk do të kalojë një shumë prej:
Në porcionin I 5,045,167.52 euro
Në porcionin II 216,412.24 euro
Dhe një kontribut financiar që nuk do të kalojë një shumë prej: 255,645.94 euro

b) Neni 1.2 dy fjalitë e para:

“Huamarrësi do të kanalizojë të gjithë porcionin I, porcionin II dhe kontributin financiar në adresë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, në përputhje me kushtet e parashtruara në nenin 2. Huamarrësi do të përdorë porcionin I të huasë ekskluzivisht për ndërtimin ose rehabilitimin e infrastrukturës në shkallë të ulët sociale dhe ekonomike. Huamarrësi do të përdorë porcionin II të Huasë ekskluzivisht për rehabilitimin e një qendre tregtare në Divjakë dhe për shërbime veterinarë në Liqenas të rajonit të Prespës. Huamarrësi do të përdorë kontributin financiar ekskluzivisht për trajnimin paraprak dhe trajnimin e mëtejshëm të “Inspektorëve socialë” të projektit ADF dhe kryesisht për të paguar kostot e shkëmbimit ndërkombëtar. Huamarrësi dhe KfW do të përcaktojnë detajet e projektit dhe mallrat e shërbimet që duhet të financohen nga huaja me anë të një marrëveshje të veçantë.”

c) Neni 4.4:

“Huamarrësi do të ripagujë huanë si më poshtë:”

Këstet	Data	Viti	Shuma	Monedha
1	30 dhjetor	2012	34,000.00	euro
2	30 qershor	2013	34,000.00	euro
3	30 dhjetor	2013	34,000.00	euro
4	30 qershor	2014	34,000.00	euro
5	30 dhjetor	2014	34,000.00	euro
6	30 qershor	2015	34,000.00	euro
7	30 dhjetor	2015	37,000.00	euro
8	30 qershor	2016	37,000.00	euro
9	30 dhjetor	2016	37,000.00	euro
10	30 qershor	2017	37,000.00	euro
11	30 dhjetor	2017	37,000.00	euro
12	30 qershor	2018	37,000.00	euro
13	30 dhjetor	2018	37,000.00	euro
14	30 qershor	2019	37,000.00	euro
15	30 dhjetor	2019	37,000.00	euro
16	30 qershor	2020	37,000.00	euro
17	30 dhjetor	2020	37,000.00	euro
18	30 qershor	2021	37,000.00	euro
19	30 dhjetor	2021	37,000.00	euro
20	30 qershor	2022	37,000.00	euro
21	30 dhjetor	2022	37,000.00	euro
22	30 qershor	2023	37,000.00	euro
23	30 dhjetor	2023	37,000.00	euro
24	30 qershor	2024	37,000.00	euro
25	30 dhjetor	2024	37,000.00	euro
26	30 qershor	2025	37,000.00	euro
27	30 dhjetor	2025	37,000.00	euro
28	30 qershor	2026	37,000.00	euro
29	30 dhjetor	2026	37,000.00	euro
30	30 qershor	2027	37,000.00	euro
31	30 dhjetor	2027	38,000.00	euro
32	30 qershor	2028	38,000.00	euro
33	30 dhjetor	2028	38,000.00	euro
34	30 qershor	2029	38,000.00	euro
35	30 dhjetor	2029	38,000.00	euro
36	30 qershor	2030	38,000.00	euro
37	30 dhjetor	2030	38,000.00	euro
38	30 qershor	2031	38,000.00	euro
39	30 dhjetor	2031	38,000.00	euro
40	30 qershor	2032	38,000.00	euro
41	30 dhjetor	2032	38,000.00	euro
42	30 qershor	2033	38,000.00	euro
43	30 dhjetor	2033	38,000.00	euro

44	30 qershor	2034	38,000.00	euro
45	30 dhjetor	2034	38,000.00	euro
46	30 qershor	2035	38,000.00	euro
47	30 dhjetor	2035	38,000.00	euro
48	30 qershor	2036	38,000.00	euro
49	30 dhjetor	2036	38,000.00	euro
50	30 qershor	2037	38,000.00	euro
51	30 dhjetor	2037	38,000.00	euro
52	30 qershor	2038	38,000.00	euro
53	30 dhjetor	2038	38,000.00	euro
54	30 qershor	2039	38,000.00	euro
55	30 dhjetor	2039	38,000.00	euro
56	30 qershor	2040	38,000.00	euro
57	30 dhjetor	2040	38,000.00	euro
58	30 qershor	2041	38,000.00	euro
59	30 dhjetor	2041	38,000.00	euro
60	30 qershor	2042	43,167.52	euro
61	30 dhjetor	2042	4,000.00	euro
62	30 qershor	2043	4,000.00	euro
63	30 dhjetor	2043	4,000.00	euro
64	30 qershor	2044	4,000.00	euro
65	30 dhjetor	2044	4,000.00	euro
66	30 qershor	2045	4,412.24	euro
TOTALI			2,261,579.76	euro

1.2 Të gjitha kushtet e tjera të marrëveshjes së huasë së datës 5.10.2002 do të mbeten të pandryshuara.

SEKSIONI 2 DISPOZITA PLOTËSUESE

2.1 Tarifa e angazhimit për shumën shtesë të huasë prej 216,412.24 euro do të llogaritet për një periudhë duke filluar tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje huaje shtesë dhe mbarimin në datat në të cilat janë debituar disbursimet.

2.2 Së fundi, para disbursimit të parë nga shuma e huasë shtesë, Huamarrësi do t'i sigurojë KfW-së fakte të kënaqshme dhe bindëse që a. Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat në përputhje me legjislacionin e tij kushtetues dhe më gjerë për vlefshmërinë e marrjes përsipër të të gjitha detyrimeve të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

2.3 Huamarrësi do të sigurojë që personat e ngarkuar nga po ai vetë për përgatitjen dhe zbatimin e projektit, dhënien e kontratave për mallrat dhe shërbimet që do të financohen dhe disbursimet e kërkuara të shumave të huasë, nuk kërkojnë, prezumojnë, shkaktajnë, japin, premtajnë ose marrin premtime për përfitimin e pagesave të paligjshme apo avantazheve të tjera në lidhje me këto detyra.

Kjo Marrëveshje plotësuese e huasë nuk do të hyjë në fuqi për sa kohë që Marrëveshja Qeveritare mbi të cilën ajo është bazuar nuk do të ketë hyrë në fuqi.

Përgatitur në tre origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, me _____ 2005.